



FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr. 415 Prot.



BASHKIA TIRANË

Nr. 37341 Prot.

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### MIDIS

“FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE”, UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË,

DHE

“BASHKIA TIRANË”

E lidhur sot më, 13 10 2017 midis palëve:

**Bashkia e Tiranës**, me adresë: “Sheshi Skënderbej”, nr.2, kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, Kryetar, në vijim e cilësuar si “**Bashkia**”

dhe

**Fakulteti i Mjekësisë Dentare**, me adresë: “Rruga e Dibrës, Nr. 371, AL1005 - Tiranë”, përfaqësuar nga Dekani, **Prof. Asc. Edit Xhajanka**, në vijim e cilësuar si “**Fakulteti**”

Meqënëse:

Në bazë të neneve 23-27, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Bashkia e Tiranës në kuadër të funksioneve dhe kompetencave të saj, është përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, në fushën e shërbimeve sociale, mbrojtjes së mjedisit kulturës, sportit, etj.

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj si më lart, Bashkia e Tiranës është angazhuar në nisma të ndryshme, duke realizuar aksione dhe fushata sensibilizuese për këtë qëllim.

Bashkia e Tiranës dhe “Fakulteti i Mjekësisë Dentare”, Tiranë, hyjnë në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi me fokus kryesor angazhimit të studentëve të “Fakultetit të Mjekësisë Dentare” në fushata vullnetare ndërgjegjësuese, të ndërmarra nga Bashkia Tiranë.

Palët lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë vijon:

## **Neni 1**

### **Objekti**

Objekti i marrëveshjes është vënia në dispozicion të Bashkisë nga Fakulteti i një numri të caktuar studentësh, të cilët do të shërbejnë si vullnetarë në nismat e ndryshme në fushën e edukimit dhe shërbimeve sociale që do të ndërmerren.

## **Neni 2**

### **Qëllimi**

Qëllimi i marrëveshjes është që, me anë të angazhimit vullnetar dhe nismave të ndryshme, të kemi një komunitet dhe qytet më të mirë, duke ndërgjegjësuar sa më shumë njerëz dhe duke i ftuar këta të fundit të bëhen pjesë e këtyre nismave.

## **Neni 3**

### **Bazaligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”.

## **Neni 4**

### **Angazhimet e Palëve**

1. Të dy palët bien dakord të bashkëpunojnë në frymën e një mirëkuptimi reciprok, si dhe me vullnetin pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e angazhimit vullnetar të studentëve në nismat dhe iniciativat e ndërmarra nga Bashkia, Tiranë, ose në bashkëpunim.
2. Palët bien dakord të shkëmbejnë eksperiencën dhe të shfrytëzojnë kapacitetet e përbashkëta njerëzore dhe teknike nëpërmjet projekteve të përbashkëta.
3. Për periudhën e angazhimit, studentët janë të detyruar t'i nënshtrohen rregullave dhe kërkesave të Bashkisë.

### Fakulteti merr përsipër:

- A. Të prezantojë paraprakisht numrin e studentëve të cilët do të angazhohen në aktivitete te ndryshme.
- B. Të respektojë rregullat e parashikuara në rregulloret e brendshme, si dhe në legjislacionin në fuqi me anë të të cilit bëhet rregullimi i funksionit të institucionit, përfshi respektimin e orareve të përcaktuara.
- C. Të hartojë një program të përbashkët me institucionin për futjen në shërbim të tij, pa pagesë të studentëve, gjatë angazhimit të tyre.
- D. Të mbështesë institucionin pritës, nëpërmjet vënies në dispozicion të stafit trajnues në projekte të përbashkëta me qëllim rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së aktivitetit.

### Bashkia merr përsipër:

- A. Pranimin e angazhimit të studentëve sipas programit të parashikuar.
- B. Ofrimin e kushteve dhe të materialeve të nevojshme për kryerjen e detyrës dhe mbikëqyrjen e punës me qëllim përfitimin e kualifikimit sa më cilësor.
- C. Dhënien e një çertifikatë për çdo student në përfundim të angazhimit.

### Neni 5

#### Dispozitat e fundit

Palët përgjigjen reciprokisht për respektimin e kësaj marrëveshje.

- Kjo marrëveshje lidhet me afat 3 vjeçar;
- Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët;
- Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje origjinale për secilën palë.

“Fakulteti i Mjekësisë Dentare”,

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Dekani

Prof.Asc. Edit Xhajanka



Bashkia Tiranë

Kryetari

Z. Erion Veliaj

